

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT  
TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik X

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

**"InfoSoft Office" sh.p.k**

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

**J62426002Q**

Nuis/Nipt

**Autostrata Tiranë-Durrës, km 8, Kashar, Tiranë**

Adresa

**Tiranë**

**Shqipëri**

**1001**

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

**00355 69 70 25 870**

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**klango@infosoftoffice.al**

E-mail

**Frederik PRODANI, Administrator i Përgjithshëm**

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

**2024/01/03**

Data (viti/muaji/dita)

**00355 69 20 36 179**

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II. Informacion mbi procedurën

### 1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*

REF-92229-12-27-2023

### 2. Lloji i Procedurës

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

Procedurë e hapur	Procedurë e hapur e thjeshtuar
<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
Procedurë e kufizuar	Procedurë konkurruese me negocim
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Partneritet për inovacion	Dialog konkurrues
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Procedurë me negocim me shpallje paraprake të njoftimit	Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shërbim Konsulence	
<input type="checkbox"/>	
Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP	
<input type="checkbox"/>	

### 3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

**Operatori i Sistemit të Transmetimit OST**

### 4. Vlera e përllogaritur e prokurimit

*(Vlera e përllogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

**3.000.000,00 (tre milion) lekë pa TVSH**

### 5. Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuader).*

**“Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST sh.a.”**

### 6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*(Data (viti/muaji/dita))*

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit  
(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

8. Data e nënshkrimit të kontratës  
(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmëri të kontratës)

---

### Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

**Ligjin për Prokurimin Publik, nr. 162 dt. 23.12.2020, në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave.**

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmëri)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

### 3. Rrethanat dhe faktet

Autoriteti Kontraktor, Operatori i Sistemit të Transmetimit OST, ka publikuar në faqen e APP-së në datë 28.12.2023, tenderin me objekt “Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST sh.a.”, i cili parashikohet të zhvillohet me datë 08.01.2024, ora 10<sup>00</sup>.

"Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST sh.a."	
Profili/Periodha   Formularet e Vlerësimit   Dokumentet e Tenderit   Njoftimet e Kontratës   Kërkesat	
Objekti i Procedurës	
Blerje kancelari për nevoja të shoqërisë OST sh.a.	
Procedurat	E hapës e thjeshtuar
Njoftimi Përfshin	Kontratë Publike
Data e Hapjes së Tenderit	28.12.2023 8:00 e paraardites
Vlera e Përlogaritur	3,500,000.00
Kodi CPV	30191000-4
Kohëzgjatja	1 muaj
Marrëveshja Kuader	
Tipi i Kontratës	Mallë
Numri	REF-92229-12-27-2023
Afati i Fundit për Pranimin e Ofertave	08.01.2024 10:00 e paraardites
Autoriteti Kontraktues	Operatori i Sistemit të Transmetimit OST

Hapi Tjetër Mbyll

Duke qenë se disa prej këtyre kërkesave i gjejnë në shkelje të LPP, Rregullave të Prokurimit Publik, po paraqesim këtë ankesë.

#### 1. Ne kriteret e vecanta ne DST, ne piken 2.3.1, AK ka kerkuar:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të cilësojë se mallrat e ofruara prej tij, janë të reja dhe jo të rikonstruara si dhe të një cilësie të lartë të cilat të garantojnë mirëfunksionimin e tyre. Operatori ekonomik ofertues, ditën dhe oren e caktuar për zhvillimin e tenderit, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor nga një mostër sipas listës së mëposhtme:

1. Stilolaps i thjeshtë me majë 0.7 mm, me kapak, me majë të hollë nikeli argjendi, trup cilindrik, me bojë blu.
2. Stilolaps rrollerball, me majë konike metalike, cilësorë, me kapak, gjerësia e vijës 0.6 mm, me ngjyrë blu, kundër avullimit të bojës.
3. Hapëse vrimash në letër min 100 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës.
4. Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 6x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.
5. Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 8,5x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.
6. Dosje Konferencash me kapak, me veshje lëkure, kapëse të fortë metalike, me xhеп të brendshëm dhe me mbajtëse stilolapsi, të zezë.
7. Letër A4 80 g/m2 e bardhë (Kuti – 5 rizme) Premium Quality.

Mosparaqitja e mostrave në vendin, ditën dhe oren e caktuar për hapjen e ofertave, konsiderohen si kusht për skualifikim.

Per artikullin *Hapëse vrimash në letër min 100 fletë, me vizore dhe me kontenier për mbetjet e letrës dhe Dosje Konferencash me kapak, me veshje lëkure, kapëse të fortë metalike, me xhep të brendshëm dhe me mbajtëse stilolapsi, të zezë*, per te cilat kerkohet te paraqiten mostra ne ditën dhe oren e percaktuar te zhvillimit te tenderit, vume re se keto dy artikuj nuk jane artikuj te pasqyruar ne formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit.

Kerkojme nga AK modifikimin e pikes 2.3.1 ne Kriteret e Vecanta te Kualifikimit dhe heqjen nga lista e mostrave qe kerkohen per dorezim per artikujt e mesiperme pasi nuk jane pjese artikujve qe kerkohen per zhvillimin e kesaj procedure.

- Per artikullin Nr. 12, AK ka kerkuar:

12	Dosje kartoni e plastifikuar A4, gjerësia min 3 cm, me llastik të gjerë min 1,2 cm.	copë	200
----	---	------	-----

Kerkesa qe dosja te kete llastik te gjere min 1.2 cm, eshte nje kerkesa e egzagjeruar dhe nuk ndikon ne funksionalitetin e dosjes. Eshte e mjaftueshme qe llastiku te kryeje funksionin e mbylljes se dosjes dhe kete funksion e kryen edhe nje llastik normal. Kerkojme qe te hiqet kerkesa "me llastik të gjerë min 1,2 cm".

- Per artikujt Nr. 13, AK ka kerkuar:

13	Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 6x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.	copë	700
----	--	------	-----

Specifikimet kaq te detajuara te vendosura nga AK te cojne drejt nje produkti/marke te caktuar, duke kufizuar ne menyre te ndjeshme konkurrencen. Permasat qe jane vendosur per dosjen jane shume fikse dhe eshte e nevojshme qe te vendoset nje tolerance  $\pm$ . Gjithashtu, kerkesat qe dosja te jete e plastifikuar dhe akoma me teper qe te jete me kokrriza ne prekje, jane kerkesa shume e egzagjeruara dhe nuk ndikojne aspak ne funksionalitetin e dosjes. Funksionin e kesaj dosjeje e kryen njesoj edhe nje dosje me material kartoni te forte. Ky eshte nje produkt konsumi, te cilin ju e prokuroni cdo vit dhe kerkesat kaq te egzagjeruara, jane te paargumentura nga ana juaj. Edhe ne PV e argumentimit, nuk keni paraqitur asnje arsye perse keto specifikime jane te domosdosshme. KPP ne shume vendime te saj, eshte shprehur qe specifikimet qe nuk ndikojne ne funksionalitetin e produktit, konsiderohen te egzagjeruara dhe duhet te hiqen.

Me poshte po paraqesim vendimin e KPP me nr. 1247/2022 date 15.12.2022 ku shprehet se:

*"Komisioni konstaton se në specifikimet teknike për artikullin nr. 11 autoriteti ka përcaktuar llojin e materialit "plastike", duke i detyruar operatorët ekonomikë të interesuar të kufizohen rreth atyre zgjidhjeve që jep autoriteti kontraktor. Komisioni gjykon, se përcaktimi i teknologjive specifike kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën. Në këto kushte, me qëllim hapjen e diapazonit të artikujve të ofertuar, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë specifikimet teknike të artikullit objekt ankimi, duke i hartuar ato bazuar në funksionalitetin që kërkohet pa përcaktuar llojin e materiali..."*

- Per artikullin Nr. 14, AK ka kerkuar:

14	Dosje A4 me mekanizëm me kuti me përmasa 8,5x32x29 cm, e plastifikuar, kutia me kokrriza në prekje, me unaze për tërheqjen e dosjes.	copë	1,300
----	--	------	-------

Specifikimet kaq te detajuara te vendosura nga AK te cojne drejt nje produkti/marke te caktuar, duke kufizuar ne menyre te ndjeshme konkurrencen. Permasat e vendosura per dosjen jane shume fikse dhe eshte e nevojshme qe te vendoset nje tolerance  $\pm$ . Gjithashtu, kerkesat qe dosja te jete e plastifikuar dhe akoma me teper qe te jete me konkriza ne prekje, jane kerkesa shume e egzagjeruara dhe nuk ndikojne aspak ne funksionalitetin e dosjes. Funksionin e kesaj dosjeje e kryen njesoj edhe nje dosje me material kartoni te forte. Ky eshte nje produkt konsumi, te cilin ju e prokuroni cdo vit dhe kerkesat kaq te egzagjeruara, jane te paargumentura nga ana juaj. Edhe ne PV e argumentimit, nuk keni paraqitur asnje arsye perse keto specifikime jane te domosdosshme. KPP ne shume vendime te saj, eshte shprehur qe specifikimet qe nuk ndikojne ne funksionalitetin e produktit, konsiderohen te egzagjeruara dhe duhet te hiqen.

Me poshte po paraqesim vendimin e KPP me nr. 1247/2022 date 15.12.2022 ku shprehet se:

*“Komisioni konstaton se në specifikimet teknike për artikullin nr. 11 autoriteti ka përcaktuar llojin e materialit “plastike”, duke i detyruar operatorët ekonomikë të interesuar të kufizohen rreth atyre zgjidhjeve që jep autoriteti kontraktor. Komisioni gjykon, se përcaktimi i teknologjive specifike kufizon në mënyrë të panevojshme konkurrencën. Në këto kushte, me qëllim hapjen e diapazonit të artikujve të ofertuar, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor, duhet të modifikojë specifikimet teknike të artikullit objekt ankimi, duke i hartuar ato bazuar në funksionalitetin që kërkohet pa përcaktuar llojin e materiali...”*

- Per artikullin Nr. 29, AK ka kerkuar:

29	Kuti kartoni arkive me kapak te përthyer me hapësirë te brendshme për dosje A4 përmasa e kutisë jo më pak se (L 40 x H 20 x D 29 cm)	copë	1,500
----	--	------	-------

Permasat e percaktuara nga ana juaj per kete artikull jane shume fikse dhe te cojne drejt nje prodhimi te caktuar, duke kufizuar konkurrencen. Kerkojme qe te caktohet nje diapazon i permasave  $\pm$  2cm.

- Per artikullin Nr. 29, AK ka kerkuar:

37	Makine stapler (qepje) dok. 24/6, me mekanizëm metalik, min 18 cm, me dy mënyra kapje.	copë	200
----	--	------	-----

Makinat qepese 24/6 jane makina per perdorim te pergjithshem, vetjak dhe eshte permasa e telit ajo qe kryen funksionin kryesor te qepjes (numrin e fleteve qe mund te qepe), te cilin ju e keni percaktuar qe duhet te jete 24/6. Kerkesa qe makina te jete min 18cm eshte e egzagjeruar, pasi te njejtin funksion kryen edhe nje makine qe eshte me e vogel se 18cm. Gjatesia e makines min 18cm, eshte shume e madhe dhe te con drejt nje produkti te caktuar. Nje makine dore normale, 24/6, eshte rreth 13cm. Kerkohet gjithashtu qe makina te jete me dy menyra kapje. Nuk kuptojme se si duhet te jene keto dy menyra te kapjes dhe cfare ndryshimi kane nga njera-tjetra? Ku per me teper qe funksioni i kesaj makine, eshte thjesht qepja e disa letrave me njera-tjetren? Ne PV e argumentimit, nuk keni paraqitur asnje arsye perse keto specifikime jane te domosdosshme. **Kerkojme qe te pranohet edhe makine me gjatesi 13cm si dhe te hiqet kerkesa " me dy menyra kapje".**

- Per artikujt Nr. 44, AK ka kerkuar:

44	Notes, me përmasa 125 mm x 75 mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500	44
----	---	------	-----	----

Përmasat 125 mm x 75 mm, te percaktuara ne milimetra, jane permasa fikse te cilat kufizojne ne menyre te ndjeshme konkurrencen. Kerkojme qe te percaktoni nje diapazon  $\pm$  5mm. Gjithashtu, kerkesa qe pesha te jete min 75gr eshte nje kerkese shume e egzagjruar dhe e panevojshme, e cila nuk ndikon ne funksionalitet. Per kete arsye kerkojme qe te hiqet "pesha min 75gr". Gjithashtu, AK nuk ka aritur te argumentoje specifikimet qe ka kerkuar.

- Per artikullin Nr. 45, AK ka kerkuar:

45	Notes, me përmasa 45 mm x 12 mm, me 100 fletë, plastike me shumë ngjyra.	copë	500	45
----	--	------	-----	----

Përmasat 45 mm x 12 mm, te percaktuara ne milimetra, jane permasa fikse te cilat kufizojne ne menyre te ndjeshme konkurrencen. Kerkojme qe te percaktoni nje diapazon  $\pm$  2mm. Gjithashtu, AK nuk ka arritur te argumentoje specifikimet qe ka kerkuar.

- Per artikullin Nr. 46, AK ka kerkuar:

46	Notes, me përmasa 76 mm x 76mm, pesha min 75 gr, me 100 fletë pakoja.	copë	500	
----	---	------	-----	--

Përmasat 76 mm x 76 mm, te percaktuara ne milimetra, jane permasa fikse te cilat kufizojne ne menyre te ndjeshme konkurrencen. Kerkojme qe te percaktoni nje diapazon  $\pm$  2mm. Gjithashtu, kerkesa qe pesha te jete min 75gr eshte nje kerkese shume e egzagjruar dhe e panevojshme, e cila nuk ndikon ne funksionalitet. Per kete arsye kerkojme qe te hiqet "pesha min 75gr".

- Per artikullin Nr. 51, AK ka kerkuar:

51	Qese A4 me vrime anash, min 60 mic, prekje me kokrriza (pako me 100 fije).	pako	600	
----	--	------	-----	--

Kerkesa qe qesja te jete me kokrriza eshte nje kerkese shume e egzagjruar dhe e panevojshme per funksionin e saj. Edhe nje qese pa kokrriza, kryen te njejtin funksion si ajo me kokrriza. Kerkojme qe te hiqet kerkesa "prekje me kokrriza".

- Per artikullin Nr. 54, AK ka kerkuar:

54	Stilo gel, me majë 0.7 mm, me kapje metalike tek kapak, me trup të gomuar, ngjyre blu	copë	250	
----	---	------	-----	--

Kerkesa qe stiloja te jete "me kapje metalike tek kapak, me trup të gomuar" eshte nje kerkese e egzagjruar , nuk ndikon aspak ne funksionalitetin e produktit dhe kufizon ndjeshem konkurrencen . Keto kerkesa kane te bejne vetem me anen vizuale te produktit dhe jo me anen funksionale. per kete arsye kerkojme heqjen e togfjaleshit "me kapje metalike tek kapak, me trup të gomuar".

- Per artikullin Nr. 55, AK ka kerkuar:

55	Stilolaps i thjeshte me majë 0.7 mm, me kapak, me majë të hollë nikeli argjendi, trup cilindrik, me bojë blu.	copë	2,500	
----	---	------	-------	--

g

Per kete artikull jeni shprehur se kerkoni nje stilolaps te thjeshte, por ne te njeten kohe percaktoni ne menyre te egzagjeruar materialin e majes dhe trupin e stilolapsit. Asnje nga keto dy specifikime, nuk ndikojne ne funksionalitetet. Funksionin kryesor tek nje stilolaps e kryen trashesia e majes (te cilen e keni percaktuar qe duhet te jete 0.7mm) dhe lloji i bojës. kerkojme te hiqet kerkesa "me majë të hollë nikeli argjendi, trup cilindrik".

- Per artikujt Nr. 62 dhe 63 AK ka kerkuar:

62	Zarf letre, me përmasa 23 cm x 33 cm.	copë	8,000
63	Zarf letre, me përmasa 30 cm x 40 cm.	copë	1,500

Specifikimet e mesiperme jane te ekzagjeruara, kane nje diapazon fiks dhe drejtojne OE drejt prodhuesve te caktuar. Keto parametra, nuk garantojne cilesine e produktit, nuk jane te justifikuara teknikisht nga ana e AK, se si ndikojne keto specifikime teknike te produkteve ne funksionalitetin e tyre. Kerkojme percaktimin e nje diapazoni  $\pm 2$ cm.

- Per artikujt Nr. 64 AK ka kerkuar:

64	Zarf letre, me përmasa 11 cm x 23 cm.	copë	1,000
----	---------------------------------------	------	-------

Specifikimet e mesiperme jane te ekzagjeruara, kane nje diapazon fiks dhe drejtojne OE drejt prodhuesve te caktuar. Keto parametra, nuk garantojne cilesine e produktit, nuk jane te justifikuara teknikisht nga ana e AK, se si ndikojne keto specifikime teknike te produkteve ne funksionalitetin e tyre. Kerkojme percaktimin e nje diapazoni  $\pm 1$ cm.

- Per artikujt Nr. 66 AK ka kerkuar:

66	Zarf me ajër 32 x 44 K7	copë	500
----	-------------------------	------	-----

Specifikimet e mesiperme jane te ekzagjeruara, kane nje diapazon fiks dhe drejtojne OE drejt prodhuesve te caktuar. Keto parametra, nuk garantojne cilesine e produktit, nuk jane te justifikuara teknikisht nga ana e AK, se si ndikojne keto specifikime teknike te produkteve ne funksionalitetin e tyre. Kerkojme percaktimin e nje diapazoni  $\pm 3$ cm.

Neni 2 i ligjit 162/2021 "Për Prokurimin Publik" parashikon shprehimisht se:

*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë eficientën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Neni 3 Parime të përgjithshme

*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në 5 mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me*



qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi. 2. **Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.** 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; 6 c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. 4. **Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.** Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”. 5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente. 6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike

*ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."*

Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Në pikën 2 të nenit 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *"Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara"*.

Me poshte, po përmendim disa raste ku edhe KPP ka dhene vendime, duke mbeshtetur arsyetimet e mesiperme.

-Ne qendrimin qe ka mbajtur KPP me Vendimin Nr. 255 /2022, shprehet:

*"Në vendimin e GJED Cëshjta C-368/10 "Komisioni Europian vs. Mbretëria e Hollandës" inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: "Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese." III.1.5. KPP gjykon se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa "dh" të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjës i tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktet e kërkuara, por pa përcaktuar kërkesa të cilat krijojnë konfuzion apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar. ....*

-Ne qendrimin qe ka mbajtur KPP me Vendimin Nr. 124 /2022, shprehet:

*"III.2.8 KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 germa "dh" se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe*

barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Referuar objektit dhe volumit të kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, thekson se, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të krijojë bindjen se operatorët ekonomikë kanë aftësi të ofrojnë produktet objekt-prokurimi, të nevojshme për zbatimin me sukses të kontratës, por gjithmonë duke përcaktuar kritere në përputhje me objektin e kontratës, në përpjesëtim me volumin e saj, si dhe jo kufizuese apo diskriminuese. Komisioni gjykon, se është e nevojshme që operatorët ekonomikë të ofrojnë produktet objekt-prokurimi por jo domosdoshmërisht në mënyrë kufizuese, pasi në fushën e veprimtarisë objekt-prokurimi, ekzistojnë edhe artikuj të tjerë ekuivalent, të cilët kanë funksionalitet të njëjtë.....”

Ju sjellim ne vemendje Rekomandimin mbi hartimin e kritereve të kualifikimit për procedurat e prokurimit punera, mallra, shërbime nga APP të datës 24.12.2021, ku APP përcakton në pikën 16 se për procedurat e hapura të thjeshtuara, si procedura në fjalë, AK duhet të përcaktojë kritere të thjeshtuara pranimit:

16. *Se fundmi, sjellim ne vemendje të autoriteteve/enteteve kontraktore se në rastin e procedurave të hapura të thjeshtuara, të përcaktojë kritere sa më të thjeshta pranimit, për operatorët ekonomikë, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm, duke mbajtur në vemendje përcaktimet e nenit 55, pika 4, të RRPP, ku parashikohet:*

*”Në këto lloje procedurash prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.”*

**Po paraqesim këtë ankesë mbështetur në LPP, Udhëzimet e APP, duke kërkuar modifikim të disa kërkesave të tenderit.**

#### 4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

*Përshkruani në mënyrë koncize shkelejt e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit kontraktor.*

Gjykojmë se është shkelur Ligji i Prokurimit Publik dhe Rregullat e Prokurimit Publik, siç kemi sqaruar në mënyrë të detajuar në pikën më lart.

#### 5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkontë)*

#### 6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

**JO**

#### 7. Lista e informacionit konfidencial:

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

**Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik**

---

Bashkangjitur:

Mandati i bankës që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik .

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail: [klango@infosoftoffice.al](mailto:klango@infosoftoffice.al)

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit  
Frederik PRODANI

Administratror i Përgjithshëm

**InfoSoft Office**  
sh.p.k